



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 473, datë 07.09.2023

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE FITUES NË
PROVIMIN E PRANIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR NDIHMËS LIGJORË, VITI AKADEMIK
2023-2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 90 pika 1, shkronja “dh” dhe 97, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 53 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VI, Seksioni A, pikat 60-62 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, për profilin ndihmës ligjor.
2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:
 1. Për z. {...} - relatore znj. Marçela Shehu;
 2. Për znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu;
 3. Për z. {...} - relatore znj. Fatmira Luli;
 4. Për znj. {...} - relatore znj. Fatmira Luli;
 5. Për z. {...} - relatore znj. Fatmira Luli;
 6. Për znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu;
 7. Për znj. {...} - relatore znj. Fatmira Luli;
 8. Për znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu;
 9. Për z. {...} - relatore znj. Fatmira Luli;
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve, të përfshirë në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR